



Pyetje të Bëra Shpesh (FAQ)

Diskriminimi, Ngacmimi Seksual dhe Ngacmime të Tjera, Frikësimi dhe Bullizmi ndërmjet Nxënësve

1 Si mund ta raportoj bullizmin dhe/ose ngacmimin seksual?

Nëse fëmija juaj po përjeton bullizëm, është e rëndësishme ta njoftoni menjëherë shkollën në mënyrë që ajo të ndërmarrë hapat e duhur për ta ndaluar këtë sjellje dhe për t'i ofruar mbështetje fëmijës suaj. Nxënësit dhe familjet mund të raportojnë shqetësimet për bullizëm dhe ngacmime në këto mënyra:

- Duke dorëzuar një ankesë në çdo gjuhë online në schools.nyc.gov/Safety ose përmes llogarisë suaj në NYC Schools Account (NYCSA) në schoolsaccount.nyc
- Duke telefonuar linjën ndihmëse të Shkollave Publike të Qytetit të New York-ut (New York City Public Schools - NYCPS), nga e hëna në të premte, ora 8AM–6PM, në numrin **718-935-2288**
- Duke dërguar email në Zyrën për Siguri dhe Zhvillim të të Rinjve (Office of Safety and Youth Development - OSYD) në RespectforAll@schools.nyc.gov
- Duke i treguar një anëtar të stafit të shkollës ose duke kontaktuar koordinatoren e programit Respect for All të shkollës
- Për çështje të ngacmimit seksual ose me bazë gjinore, kontaktoni koordinatoren e Title IX në numrin **718-935-4987** ose Title_IX_Inquiries@schools.nyc.gov

Pas raportimit, prindërit/kujdestarët mund të kërkojnë nga drejtuesit e shkollës numrin e incidentit, i njohur edhe si numri nga Sistemi Online për Raportimin e Ngjarjeve (Online Occurrence Reporting System - OORS).

Prindërit/kujdestarët duhet të njoftohen jo më vonë se dy ditë mësimore pasi shkolla të ketë marrë raportimin.

2 A janë konfidenciale raportimet për bullizëm dhe ngacmim?

Po, shkolla e kupton se raportimi është i ndjeshëm dhe do të bëjë çmos për ta mbajtur atë konfidencial. Informacioni ndahet vetëm kur është i nevojshëm për hetim ose për të mbrojtur sigurinë e nxënësve dhe komunitetit shkollor.

Prindërit/kujdestarët njoftohen për çdo incident që përfshin fëmijën e tyre. Nxënësit duhet të flasin me shkollën nëse kanë shqetësime rreth njoftimit të prindit/kujdestarit për një raportim. Shkolla mund të ndihmojë duke bashkëpunuar me nxënësin dhe prindin/kujdestarin dhe duke ofruar mbështetje.

Nëse raportimi përfshin një krim, shkolla është e detyruar të njoftojë Departamentin e Policisë së Nju Jorkut (NYPD) (New York Police Department).

3 Si hetohen ankesat?

Një anëtar i stafit të shkollës do të hetojë ankesën tuaj duke:

- Biseduar veçmas me staf, nxënës ose persona të tjerë që kanë qenë të përfshirë në incident ose kanë qenë dëshmitarë, për të kuptuar çfarë ka ndodhur
 - Mund të kërkohet informacion ose prova të tjera të vlefshme, si video, mesazhe tekst ose postime në rrjete sociale
- Kërkuar nga personat e përfshirë ose dëshmitarët që të përgatisin një deklaratë me shkrim

Shkolla do të shqyrtojë të gjitha informacionet e mbledhura gjatë hetimit dhe do të marrë një vendim për atë që ka ndodhur dhe si të mbështesë fëmijën tuaj.

4 Si do të njoftohem për vendimin e shkollës pas përfundimit të hetimit?

Në përfundim të hetimit, familjet do të informohen për rezultatin brenda dhjetë ditëve mësimore. Nëse është e nevojshme, nxënësit mund të referohen për shërbime mbështetëse.

Prindërit/kujdestarët e nxënësve të përfshirë në një incident do të marrin informacion vetëm për fëmijën e tyre. Shkolla nuk do të ndajë me familjet informacion mbi masat disiplinore apo mbështetjet që i jepen një nxënësi tjetër.

5 Çfarë lloj mbështetjesh mund të ofrojë shkolla nëse fëmija im ndihet i pasigurt apo ka nevojë për ndihmë, dhe si mund të kërkoj mbështetje?

Ju mund të kërkonj mbështetje në çdo moment: përpara, gjatë ose pas një hetimi.

Shkolla ka në dispozicion mënyra të ndryshme për të mbështetur nevojat individuale të fëmijës suaj. Për shembull, ata mund të:

- Lidhin fëmijën tuaj me një këshilltar shkollë, punonjës social, psikolog ose profesionist të shëndetit mendor nga komuniteti
- Ju ndihmojnë të shqyrtoni mbështetje akademike dhe përshtatje të orarit, si ndërrim klasash, ndryshim të periudhës së drekës/pushimit ose programit pas shkollës

- Bashkëpunojnë me fëmijën tuaj për të ndërtuar një plan mbështetës individual, që mund të përfshijë takime të rregullta me një anëtar të caktuar të stafit të shkollës për një periudhë kohe, për t'u siguruar që sjellja të ndalojë.

Nëse fëmija juaj ka një aftësi të kufizuar dhe jeni të shqetësuar se një incident po ndikon në procesin e të mësuarit, bisedoni me ekipin e Programit Arsimor Individual (Individualized Education Program - IEP), ekipin e Seksionit 504, dhe administratorin e shkollës.

6 Çfarë burimesh janë të disponueshme brenda dhe jashtë shkollës nëse fëmija im ka nevojë për ndihmë?

Shkolla juaj ka një përfaqësues të dedikuar për programin Respect for All (RFA) dhe një përfaqësues për Parandalimin e Ngacimit Seksual (Sexual Harassment Prevention - SHP) për të ndihmuar nxënësit dhe familjet që janë prekur nga bullizmi apo ngacmimi. Emrat e këtyre përfaqësuesve mund t'i gjeni në seksionin "School Contacts and Information" (Kontaktet dhe Informacioni i Shkollës) në faqen e shkollës suaj në schoolsearch.schools.nyc.gov. Emrat e tyre gjithashtu shfaqen në postera të vendosur nëpër ambiente të ndryshme të shkollës. Nëse një prind/kujdestar ose një nxënës ka pyetje gjatë procesit të hetimit, ata mund të kontaktojnë përfaqësuesin RFA, SHP ose drejtorin e shkollës.

Për raste të caktuara të ngacimit seksual: Title IX — një ligj federal që ndalon diskriminimin mbi bazën e seksit në çdo shkollë ose program arsimor që financohet nga qeveria federale — kërkon që ekipi Title IX i NYCPS të kryejë një hetim të veçantë, përveç atij që bën shkolla. Hetimi i kryer nga ekipi Title IX është i ndarë nga ai i shkollës. Ju do të njoftoheni nëse edhe ekipi Title IX e heton incidentin. Për më shumë informacion rreth Title IX, vizitoni schools.nyc.gov/TitleIX.

Nëse përjetoni ose jeni dëshmitar i një incidenti ngacmimi, diskriminimi ose bullizmi, ju lutemi njoftoni përfaqësuesin Respect for All të shkollës suaj, drejtorin ose një të rritur të besuar në shkollë, i cili do të ndërmarrë hapat e duhur për të bërë një raportim.

Nëse dëshironi të raportoni incidentin drejtpërdrejt, ju mund të përdorni një nga opsionet më poshtë:

- Telefononi Linjën Anti-Urrejtje (Anti-Hate Hotline) në **718-935-2889**, nga e hëna në të premte, prej orës 8 a.m. deri 6 p.m. Raportimet mund të bëhen edhe në mënyrë anonime.
- Bëni një raportim në nycenet.edu/BullyingReporting për çdo incident ndërmjet nxënësve
- Bëni një raportim në nycenet.edu/OEO për çdo incident që përfshin personel/shkollën
- Ju gjithashtu mund të na dërgoni email në RespectForAll@schools.nyc.gov ose të telefononi Linjën Mbështetëse për Bullizmin P311 në **718-935-2288**

Nëse preferoni të flisni me dikë jashtë shkollës suaj:

- **NYC 988** ofron mbështetje falas, konfidenciale për shëndetin mendor për banorët e Nju Jorkut të të gjitha moshave. Ju mund të flisni me një këshilltar nëpërmjet telefonit, mesazhit ose bisedës online, dhe të merrni akses në shërbime për shëndetin mendor dhe përdorimin e substancave, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë:
 - Telefononi ose dërgoni mesazh në: **988**
 - Bisedoni tani online në: 988lifeline.org/Chat
 - Gjeni shërbime në: nyc.gov/988

Ju lutemi vizitoni schools.nyc.gov/RespectForAll ose pyesni drejtpërdrejt shkollën tuaj për më shumë informacion mbi mundësitë e ndryshme të mbështetjes që janë të disponueshme për familjen tuaj.

7 Si mund të marr ndihmë nëse kam nevojë për më shumë mbështetje sesa ajo që ofron shkolla?

Nëse ju duhet më shumë ndihmë se ajo që po ofron shkolla, ju mund të bëni një nga veprimet e mëposhtme:

- Dërgoni një ankesë online duke kërkuar ndihmë shtesë në nycenet.edu/BullyingReporting
- Flisni me përfaqësuesin "Respect for All" të shkollës ose me një të rritur të kujdesshëm në shkollë
- Kontaktoni Zyrën "Respect for All" duke dërguar email në RespectForAll@schools.nyc.gov
- Plotësoni Formularin e Kërkesës për Mbështetje të Shtuar nga Stafi (Escalation Staff Assistance Request Form), schools.nyc.gov/RespectForAll i cili gjendet nën seksionin "Escalation Assistance" (Mbështetje Shtesë) Dërgojeni formularin e plotësuar me email te Koordinatori për Mbështetjen e Familjeve për distriktin tuaj shkollor. Adresën e emailit të tij/saj e gjeni këtu schools.nyc.gov/Superintendents.

8 Ku mund të mësoj më shumë rreth politikave dhe procedurave të NYCPS për bullizmin dhe ngacmimet?

Për më shumë informacion mbi politikat dhe procedurat e Shkollave Publike të Qytetit të Nju Jorkut (NYCPS), ju lutemi lexoni Rregulloren e Kancelarit (Chancellor's Regulations) **A-831** dhe **A-832** (schools.nyc.gov/VolumeA).